



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

KOMISIONI AD-HOC - RENTA MINERARE

VENDIM

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 7 datë 4.01.2012 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare” të ndryshuar, Urdhrit të Ministrit të Financave nr 26, datë 27.04.2012 “Për ngritjen e Komisionit *ad-hoc* për përcaktimin e listave për vlerat referuese sipas normativave teknologjike të produkteve që përdorin minerale”, të ndryshuar, Komisioni Ad-Hoc, në mbledhjen e datës 23.01.2014, vendosi:

1.Në fund të pikës 10, të faqes 20 të Raportit Nr. 16365 Prot., datë 17.10.2012, të shtohet fjalia me këtë përmbajtje:


“Tabela nr. 2: “Lista e produkteve minerare për të cilët vlera e rentës minerare përllogaritet bazuar në vlerën e mineralit të papërpunuar pa një çmim bazë të përcaktuar në tabelën e çmimeve dhe sipas vlerës së normativës për produktin mineralar dhe koeficientit që merr në konsideratë kostot e përpunimit dhe fitimin për efekt të përpunimit për të dalë në mineralin bazë”, do të përditësohet në rast të ndryshimit me +/- 10 % të çmimit të bakrit të publikuar në LME, mbi të cilin është bërë llogaritja e metodologjisë së përcaktimit të rentës minerale për bakrin. Dinamikën e ndryshimit të çmimit sipas LME, e raportojnë anëtarët e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, pranë Komisionit.”

2.Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të bëjë investigimin e tregut për rikonfirmimin e çmimit referues të tregut të mineralit të përfshirë në nënprodukt, të dhënë në kolonën 6 të Tabelës 1. “Lista e nën-produkteve minerare për të cilët renta minerare llogaritet mbi vlerën e mineralit të përfshirë në nënprodukt, bazuar në normativat teknologjike dhe çmimin e tregut të mineralit” .”

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarët e Komisionit Ad-Hoc:

Nr.	Emri	Pozicioni	Institucioni	Firma
1	Znj. Arjana DYRMISHI	Kryetare	Ministria e Financave	
2	Znj. Elida FARA	Anëtar	Ministria e Financave	
3	Znj. Violeta ZAIMI	Anëtar	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	
4	Z. Ajet LAZE	Anëtar	Drejtoria Rajonale Tatimore	
5	Z. Oltion KUKË	Anëtar	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	
6	Z. Gerti GORENCA	Anëtar	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	
7	Znj. Flutura MADHI	Anëtar	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	
8	Z.Mehmet HASALAMI	Anëtar	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	

9	Z.Dritan SPAHIU	Anëtar	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	
10	Z.Azbi ARAPI	Anëtar	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	
11	Z. Agron XHAVO	Anëtar	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	